

Ligji Nr. 08/L-261**PËR MBROJTJE NGA ZJARRI****Kuvendi i Republikës së Kosovës:**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR MBROJTJE NGA ZJARRI**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin, si dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e sistemit dhe mekanizmave të mbrojtjes nga zjarri, duke përfshirë edhe shpërthimet me qëllim të mbrojtjes së jetës së njerëzve, kafshëve, pasurisë dhe mjedisit.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, veprimtaria e të cilëve ndërlidhet me mbrojtjen nga zjarri.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë ligj kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1. Ministria – nënkupton Ministria përgjegjëse për punë të brendshme;
- 1.2. Ministri – nënkupton Ministri i Ministrisë përgjegjëse për punë të brendshme;
- 1.3. AME - nënkupton Agjencia për Menaxhimin Emergjent;
- 1.4. Mbrojtja nga zjarri - nënkupton tërësinë e masave dhe veprimeve të cilat ndërmerren në parandalimin e shkaktimit të zjarrit apo për zvogëlimin e pasojave nga zjarri;
- 1.5. Inspektor - nënkupton inspektorin për mbrojtje nga zjarri në kuadër të AME-së, i cili është i autorizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të masave mbrojtëse nga zjarri;
- 1.6. Prona - nënkupton pronën e paluajtshme dhe të luajtshme, e cila është në pronësi të personit fizik apo juridik, siç është përcaktuar në ligjin përkatës për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore;
- 1.7. Pronar - nënkupton personi fizik apo juridik që ka në pronësi pronën;
- 1.8. Shfrytëzues - nënkupton personi fizik apo juridik që ka në shfrytëzim pronën në mënyrë të ligjshme;

- 1.9. Kategorizimi - nënkupton klasifikimin e objekteve dhe pjesëve të objekteve në bazë të shkallës së rrezikshmërisë nga zjarri;
- 1.10. Plani Shtetëror për Mbrojtje nga Zjarri – nënkupton përcaktimin e detyrave, zonave të veprimit, si dhe fushave të përgjegjësisë dhe veprimtarisë për mbrojtje nga zjarri në nivel vendi;
- 1.11. Plani Komunal për Mbrojtje nga Zjarri – nënkupton përcaktimin e detyrave, zonave të veprimit, si dhe fushave të përgjegjësisë dhe veprimtarisë për mbrojtje nga zjarri në nivel Komunal;
- 1.12. Vlerësimi i rrezikut – nënkupton përcaktimin e shkallës së rrezikut nga zjarri në një vend apo vendndodhje të veçantë, si dhe masat e duhura mbrojtëse;
- 1.13. Objektet - nënkupton ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave si pasuri e paluajtshme;
- 1.14. Mjedisi - nënkupton rrethina natyrore, ajri, toka, uji, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgiminë kulturore si pjesë e rrethinës që e ka krijuar njeriu;
- 1.15. Institucionet Shtetërore – nënkupton institucionet përkatëse kompetente, të nivelit Qendror dhe Komunal, për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri;
- 1.16. Zjarri - nënkupton procesin vet mbështetës të djegies që përhapet në mënyrë të pakontrolluar në hapësirë;
- 1.17. Djegia - nënkupton reaksion të shpejtë kimik të ndonjë lënde me një oksidant, më së shpeshti me oksigjenin nga ajri, në të cilin formohen produkte të djegies dhe lirohet nxehtësia, flaka dhe drita;
- 1.18. Shpërthimi teknologjik- nënkupton përhapjen e papritur të gazeve për shkak të djegies ose reaksioneve të tjera kimike;
- 1.19. Rezistenca ndaj zjarrit - nënkupton qëndrueshmërinë e objekteve ndaj zjarrit me kalimin e kohës, përmbushjen e kapaciteteve të kërkuara të ngarkesës, tërësisë, izolimit termik dhe vetitë e tjera të pritshme, siç përcaktohet nga standardet e rezistencës së materialeve ndaj zjarrit;
- 1.20. Reagimi ndaj zjarrit - nënkupton materialin i cili kontribuon në përhapjen e zjarrit për shkak të dekompozimit të tij, i cili ndodh duke e ekspozuar atë material në kushte të caktuara testimi;
- 1.21. Rreziku i drejtpërdrejtë - nënkupton gjendjen e rrezikut të lartë nga zjarri, e cila në çdo kohë mund të shkaktojë zjarr të menjëhershëm;
- 1.22. Rruga e evakuimit nga objekti - nënkupton rrugën e veçantë e projektuar dhe e ndërtuar në objekt që shpie nga çdo pikë brenda objektit në hapësirën e jashtme ose hapësirën e sigurt në objekt, me qëllim të evakuimit të personave të përfshirë nga zjarri dhe largimin e tyre në mënyrë të sigurt;
- 1.23. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri- nënkupton planifikimin, përcaktimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri për objekte, organizimin e subjekteve të mbrojtjes nga zjarri, zbulimin e hershëm, lajmërimin e shfrytëzuesit të objektit për shpërthimin, pengimin e përhapjes së zjarrit dhe tymit në objekt, efektivitetin e shuarjes së zjarrit, financimin e mbrojtjes nga zjarri, trajnimin dhe licencimin për kryerjen e aktiviteteve të mbrojtjes nga zjarri të jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve, të mirave materiale, mjedisit dhe natyrës me rrezik të pranueshëm nga zjarri.

1.24. Certifikata e përdorimit - nënkupton dokumentin që lëshohet sipas ligjit përkatës për ndërtim për të treguar se ndërtimi është i përshtatshëm për përdorim.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë ligj, kanë kuptimin sipas ligjeve relevante në fuqi.

KAPITULLI II ORGANIZIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 4 Përgjegjësitë e Ministrisë

1. Ministria është përgjegjëse për:

- 1.1. Planifikimin, organizimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri;
- 1.2. Analizimin e gjendjes për mbrojtje nga zjarri dhe ndërmarrjen e masave për përmirësim;
- 1.3. Propozimin e programit vjetor për mbrojtje nga zjarri, të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Kosovës;
- 1.4. Propozimin e Planit Shtetëror për Mbrojtje nga Zjarri të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Kosovës;
- 1.5. Hartimin e programeve të trajnimit dhe ngritjes profesionale të kuadrove për mbrojtje nga zjarri.

2. Për zbatim të nën-paragrafëve 1.4 dhe 1.5. të këtij neni, Ministri nxjerr akt nënligjor.

Neni 5 Përgjegjësitë e Komunave

1. Komunitat janë përgjegjëse për:

- 1.1. Nxjerrjen e Planit për Mbrojtje nga Zjarri në nivel Komunal në bazë të vlerësimit të rrezikut nga zjarri, në pajtim me Planin Shtetëror për Mbrojtje nga Zjarri;
- 1.2. Zbatimin dhe përmirësimin e masave për mbrojtje nga zjarri dhe avancimin e tyre;
- 1.3. Së paku një herë në vit, rishikojnë Planin për Mbrojtje nga Zjarri

Neni 6 Përgjegjësitë e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent

1. Agjencia e Menaxhimit Emergjent është përgjegjëse për:

- 1.1. Menaxhimin e emergjencave, sipas mandatit të saj;
- 1.2. Hartimin e Dokumentit për Vlerësimin e Rrezikut nga Zjarri;
- 1.3. Hartimin e Planit Shtetëror për Mbrojtje nga zjarri;
- 1.4. Hartimin e Programit Vjetor për Mbrojtje nga Zjarri;

- 1.5. Mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji;
- 1.6. Hartimin dhe miratimin e udhëzuesve lidhur me të gjitha veprimtaritë për mbrojtje nga zjarri;
- 1.7. Vlerësimin e përputhshmërisë së Planit për Mbrojtje nga Zjarri të Komunës në raport me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera në fuqi.

KAPITULLI III

KATEGORIZIMI I OBJEKTEVE DHE MASAT MBROJTËSE NGA ZJARRI

Neni 7

Kategorizimi i objekteve

1. Ministria kategorizon objektet dhe pjesët e objekteve sipas rrezikut nga zjarri në varësi të procesit teknologjik që zhvillohet në to, llojet dhe sasi të materialeve të prodhuara, të përpunuara ose të ruajtura, llojet e materialeve të përdorura për ndërtimin e objektit, rëndësinë dhe madhësinë e objektit.
2. Objektet dhe pjesët e objekteve sipas rrezikshmërisë nga zjarri kategorizohen si në vijim:
 - 2.1. Kategoria e I – rë ku hyjnë objektet dhe pjesët e objekteve varësisht prej procesit teknologjik që zhvillohet në to;
 - 2.2. Kategoria e II - të ku hyjnë objektet dhe pjesët e objekteve sipas llojit të materialit që prodhohet, përpunohet apo deponohet;
 - 2.3. Kategoria e III- të ku hyjnë objektet dhe pjesët e objekteve sipas llojit të përbërjes së materialeve;
 - 2.4. Kategoria e IV- të ku hyjnë objektet dhe pjesët e objekteve sipas rëndësisë së tyre.
3. Kategorizimi dhe klasifikimi i objekteve dhe pjesëve të objekteve në kategoritë përkatëse të rrezikshmërisë nga zjarri sipas paragrafit 2 të këtij neni, përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.
4. Përjashtimisht përcaktimeve të këtij neni, kategorizimi i objekteve ushtarake bëhet nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 8

Masat për mbrojtje nga zjarri sipas kategorive

1. Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve janë të obliguar të marrin masa për mbrojtje nga zjarri të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji, si dhe në përputhje me Planin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe planin e evakuimit.
2. Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve, janë të detyruar të ndërmarrin masa, si në vijim:
 - 2.1. Për kategorinë e I-rë të rrezikshmërisë janë të obliguar që:
 - 2.1.1. të hartojnë Planin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Planin e Evakuimit në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë;
 - 2.1.2. të formojnë njësitë e mbrojtjes nga zjarri me personel të nevojshëm;

2.1.3. të sigurojnë mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për mbrojtje nga zjarri;

2.1.4. të sigurojnë zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri.

2.2. Për kategorinë e II-të të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar që:

2.2.1. të hartojnë Planin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Planin e Evakuimit në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë;

2.2.2. të kenë numër të mjaftueshëm të punëtorëve që janë të trajnuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri;

2.2.3. të sigurojnë mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për mbrojtje nga zjarri;

2.2.4. të sigurojnë që të punësuarit do të kryejnë kujdestarinë për fikjen e zjarrit;

2.2.5. të sigurojnë zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri.

2.3. Për kategorinë e III-të të rrezikshmërisë nga zjarri janë të obliguar:

2.3.1. të kenë së paku një punëtor që është i trajnuar, i cili drejtpërdrejt organizon dhe përkujdeset për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri;

2.3.2. të kenë një plan evakuimi;

2.3.3. të sigurojnë zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri.

2.4. Për kategorinë e IV-t të rrezikshmërisë nga zjarri janë të obliguar:

2.4.1. të kenë së paku një punëtor të trajnuar, i cili ngarkohet me punët e mbrojtjes nga zjarri;

2.4.2. të kenë një plan evakuimi;

2.4.3. të sigurojnë zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri.

3. Pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve, të cilët kategorizohen në kategorinë e parë dhe të dytë të rrezikshmërisë, Planin e Mbrojtjes nga Zjarri duhet ta nxjerrin në harmoni me Planin Komunal për Mbrojtje nga Zjarri.

4. Pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve që janë përgjegjës për aktivitetet e mbrojtjes nga zjarri, duhet të kenë të punësuar persona që kanë të kryer trajnimet profesionale për zjarrfikës apo të drejtimit teknik dhe të cilët e kanë kaluar provimin profesional për mbrojtje nga zjarri.

5. Ministri me akt nënligjor përcakton kriteret për hartimin dhe përmbajtjen e Planit të Evakuimit sipas këtij neni.

Neni 9 **Masat mbrojtëse**

1. Institucionet përkatëse të nivelit Qendror dhe Lokal, kur hartojnë dokumente të planifikimit hapësinor lidhur me masat e mbrojtjes nga zjarri duhet t'i përmbahen dispozitave të këtij ligji.

2. Pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve, varësisht nga kushtet

dhe nevojat e tyre, obligohen që aktet e brendshme për mbrojtje nga zjarri t'i harmonizojnë me Planin për Mbrojtje nga Zjarri dhe me dispozitat e këtij ligji, si dhe të përcaktojnë masat dhe veprimet në lidhje me zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 10

Kushtet e veçanta të ndërtimit me qëllim të mbrojtjes nga zjarri

1. Me qëllim të plotësimit të kushteve të veçanta për mbrojtje nga zjarri për objektet e kategorisë I dhe II sipas dispozitave të këtij ligji, AME jep:

1.1. Pëlqimin për mbrojtje nga zjarri në lokacionin e paraparë me projektin ideor me qëllim të marrjes së kushteve ndërtimore;

1.2. Pëlqimin për mbrojtje nga zjarri në projektin kryesor për përcaktimin e kushteve të veçanta të mbrojtjes nga zjarri të cilat janë të nevojshme për marrjen e lejes së ndërtimit nga organi kompetent.

2. Kushtet e veçanta të ndërtimit me qëllim të mbrojtjes nga zjarri për objektet e larta dhe kategoritë e përcaktuara sipas nenit 7 të këtij ligji përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria me propozim të Ministrisë, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për planifikim hapësinor.

3. Procedura e dhënies së pëlqimit sipas paragrafit 1 të këtij neni bazohet në dispozitat e ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative

Neni 11

Masat e parapara për mbrojtje nga zjarri

1. Personat juridikë të regjistruar për projekte duhet që për objektet në të cilat kërkohen kushte të veçanta ndërtimi të tregojnë në mënyrë grafike, të përlllogaritura dhe të shpjeguara me shkrim masat e mbrojtjes nga zjarri të parashikuara në projektin kryesor, me qëllim të vlerësimit të masave për mbrojtje nga zjarri.

2. Pëlqimi për masat e parapara të mbrojtjes nga zjarri është pjesë përbërëse e projektit kryesor nga paragrafi 1 i këtij neni, për dhënie të lejes ndërtimore.

3. Personat juridikë të regjistruar për projekte, të cilët e kanë hartuar projektin kryesor, kryejnë verifikimin e të njëjtit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e tyre të brendshme.

4. Pas verifikimit sipas paragrafit 3 të këtij neni, personat juridikë duhet të bashkëngjisin deklaratën me të cilën vërtetojnë se masat për mbrojtje nga zjarri të aplikuara në projektet kryesore janë në harmoni me këtë ligj, kriteret e rregullimit hapësinor dhe kriteret dhe normativat teknike.

5. Me rastin e projektimit dhe ndërtimit të objekteve të banimit kolektiv, objekteve publike, qendrave tregtare, hoteleve, kinemave, teatrove, bibliotekave, postave, spitaleve, sallave sportive, pallateve të koncerteve si dhe objekteve të tjera publike, duhet të sigurohen kushtet për evakuim të papenguar të njerëzve në rast të shpërthimit të zjarrit me ndërtimin e shkallëve për evakuim, si dhe me pajisje përkatëse për alarm dhe fikje të zjarrit.

6. Personat juridikë të regjistruar për projekte sipas paragrafi 1 të këtij neni, duhet të kenë të punësuar persona që kanë trajnime përkatëse profesionale dhe të kenë kaluar provimin profesional nga fusha e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 12**Kushti për dhënien e lejes për ndërtim**

Organi kompetent për dhënien e lejes për ndërtim apo rikonstruktiv, mund të japë lejen për ndërtim vetëm atëherë kur të sigurohet se projekti kryesor për ndërtim, në bazë të cilit jepet leja e ndërtimit, ka paraparë përmbushjen e kushteve të posaçme të ndërtimit me qëllim të mbrojtjes nga zjarri siç është përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 13**Certifikata e përdorimit**

1. Certifikata e përdorimit të objektit apo objekteve të ndërtuara ose rikonstruktiv, jepet atëherë kur vërtetohet se janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zjarri të parapara në projektin kryesor të ndërtimit.

2. Inspektori për mbrojtje nga zjarri, në bashkëpunim me Inspektoratin përkatës për Ndërtim, bën inspektimin final të vend ndërtimit dhe poseduesi i lejes ndërtimore duhet t'i sigurojë qasje të papenguar në vend ndërtim.

3. Nëse gjatë kryerjes së inspektimit final, vërtetohet se me rastin e ndërtimit, apo rikonstruktimit të objektit nuk janë zbatuar masat për mbrojtje nga zjarri të parapara në projektin kryesor të ndërtimit, nuk do të jepet certifikata e përdorimit derisa të jenë zbatuar masat për mbrojtje nga zjarri.

4. Pas përfundimit të inspektimit final nga Inspektori për mbrojtje nga zjarri, AME në bazë të raportit të Inspektorit mbi plotësimin e masave për mbrojtje nga zjarri përgatit raportin, me të cilin vërteton se objekti i inspektuar mund të shfrytëzohet, përkatësisht plotëson kushtet për dhënien e certifikatës së përdorimit.

Neni 14**Materiali rezistues ndaj zjarrit**

1. Gjatë projektimit dhe ndërtimit të objektit dhe pjesëve të objektit duhet të sigurohet mbrojtja nga zjarri si një nga kërkesat thelbësore për objektet e përcaktuara, sipas kategorive që rregullojnë fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, në mënyrë që në rast zjarri të:

1.1. ruhet kapaciteti mbajtës i strukturës për një periudhë të caktuar kohore;

1.2. parandalohet përhapja e zjarrit dhe tymit brenda objektit dhe pjesës së objektit;

1.3. parandalohet përhapja e zjarrit në objektet, apo pjesët e objekteve fqinje;

1.4. mundësohet largimi i personave që të largohen nga objekti, apo pjesët e objekteve pa u dëmtuar, gjegjësisht t'ju mundësohet shpëtimi i tyre;

1.5. mundësohet mbrojtja e reaguesve të parë.

2. Konsiderohet se kërkesa thelbësore e mbrojtjes nga zjarri përmbushet nëse objekti i plotëson kërkesat teknike të mbrojtjes nga zjarri, si dhe në përputhje me vlerësimin e ndikimit mjedisor. Kërkesat teknike të mbrojtjes nga zjarri përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri.

3. Kërkesa thelbësore e mbrojtjes nga zjarri vërtetohet edhe sipas metodave llogaritëse që janë të ndryshme nga mënyra e vërtetimit, përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni. Metodatat llogaritëse përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri.

4. Punët përfundimtare të sipërfaqeve vertikale dhe horizontale të daljeve dhe rrugëve dalëse në objekte, duhet të jenë të ndërtuara nga material me karakteristika rezistuese ndaj zjarrit.

5. Për materialet e përdorura për ndërtim nga paragrafi 4 i këtij neni, kryesi i punimeve duhet të sigurojë dëshminë për karakteristikat e materialit rezistues ndaj zjarrit nga prodhuesi gjatë ndërtimit, të cilën ja ofron për verifikim inspektorëve sipas paragrafit 2 të nenit 13 të këtij ligji.

Neni 15

Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve

1. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve, janë të obliguar të mirëmbajnë në gjendje të rregullt pajisjet, instalimet, ventilimet e gazrave, oxhaqet, si dhe pajisjet e tjera të cilat paraqesin rrezik për zgjerimin e zjarrit, në harmoni me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve për të cilat duhet të ketë dokumentacion.

2. Për instalimin e pajisjeve statike të destinuara për lajmërimin dhe fikjen e zjarrit, detektimin e gazrave dhe avujve të ndezshëm, si dhe pajisjet tjera mbrojtëse dhe instalimeve të cilat shërbejnë për evitimin e shkaktimit dhe zgjerimin e zjarrit dhe shpërthimit, kryesi i punëve është i detyruar të sigurojë dëshminë nga prodhuesi për funksionim të rregullt të tyre dhe raport mbi verifikimet e kryera nga personi juridik i licencuar sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve përmes kontratës përcaktojnë obligimet sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

4. Në qoftë se nuk mund të vërtetohet pronari i objektit nga paragrafi 1 i këtij neni, obligimet e përcaktuara i bien në barrë shfrytëzuesit.

Neni 16

Dëshmia për gjendjen e rregullt të pajisjeve

1. Pajisjet sipas paragrafit 2 të nenit 15 të këtij ligji duhet të kontrollohet të paktën një (1) herë në vit nga personat e licencuar, sipas paragrafit 5 të këtij neni, në përputhje me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve.

2. Me rastin e kontrollit sipas paragrafit 1 të këtij neni, mbahet procesverbal në të cilin shënohet se kur është kryer kontrolli, kush e ka kryer dhe çfarë është vërtetuar.

3. Aparatet bartëse dhe lëvizëse për shuarjen e zjarreve duhet të kontrollohen çdo gjashtë (6) muaj.

4. Personat juridikë të licencuar që kryejnë kontrollimin duhet të kenë kaluar provimin përkatës profesional.

5. AME lëshon leje për kryerje e aktiviteteve nga paragrafi 2 i nenit 15 dhe paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 17

Regjistrimi për prodhim, qarkullim dhe importim të pajisjeve dhe stabilimenteve

1. Personat juridikë duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e AME-së për të ushtruar veprimtarinë e prodhimit, qarkullimit dhe importimit të pajisjeve, stabilimenteve dhe mjeteve të dedikuara për fikje të zjarrit, lajmërim dhe pengim të zgjerimit të zjarrit dhe pajisjeve të tjera mbrojtëse e instalimeve, përfshirë edhe pajisjet mbrojtëse dhe personale të zjarrfikësve, të cilat i shfrytëzojnë për fikjen e zjarrit dhe intervenimet e tjera.

2. Pajisjet, mjetet dhe stabilimentet nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilat importohen nga jashtë,

mund të vihen në qarkullim vetëm nëse importuesi e ka marrë certifikatën e prodhuesit të pajisjeve mbi rregullsinë e atyre pajisjeve, mjeteve dhe stabilimenteve, si dhe përshtatjen e tyre për qëllimet e dedikuara.

3.Për çdo pajisje të importuar dhe për çdo sasi të importuar të pjesëve të pajisjeve apo mjeteve për fikje të zjarrit, alarmim dhe pengim të përhapjes së zjarrit, importuesi është i obliguar që të sigurojë certifikatën e paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, përveç nëse kjo është e rregulluar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.

4. Kushtet dhe kriteret për prodhim, qarkullim dhe importim të pajisjeve dhe stabilimenteve sipas këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 18

Pajisjet, mjetet dhe stabilimentet për fikjen e zjarrit

1. Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe/apo mjedisit, obligohen të posedojnë pajisjet, mjetet dhe stabilimentet për fikjen e zjarrit.

2.Pajisjet, mjetet dhe stabilimentet për fikje të zjarrit duhet të shfrytëzohen vetëm sipas dedikimit dhe duhet të jenë në gjendje të rregullt, me shenja të veçanta dhe lehtësisht të qasshme për përdorim.

3. Ministri me akt nënligjor përcakton:

3.1. Rregullat dhe procedurat për testim dhe servisim të pajisjeve, mjeteve dhe stabilimenteve për fikje të zjarrit;

3.2. Normat teknike për rrjetin e hidrantëve për fikjen e zjarrit;

3.3. Normat teknike për mbrojtje nga zjarri të infrastrukturës elektroenergjetike dhe pajisjeve.

Neni 19

Kujdestaria e zjarrfikësve

1. Me qëllim të pengimit dhe mënjanimi të rrezikut nga zjarri, duhet të sigurohet kujdestaria e zjarrfikësve, gjegjësisht shërbimi vëzhgues alarmues, si dhe pajisje dhe mjete përkatëse për fikje të zjarrit për rastet, si në vijim:

1.1. Në objekte, gjatë mbajtjes së ngjarjeve publike apo aktiviteteve tjera;

1.2. Në ambiente të hapura në kohën kur vlerësohet apo supozohet rreziku për paraqitje të zjarrit në mjedise të tilla, kryerja e korrje-shirjeve të përmasave të mëdha, kantieret e mëdha, parqet nacionale, pyjet dhe të ngjashme.

2. Kujdestarinë e zjarrfikësve, respektivisht shërbimin vëzhgues-alarmues në rastet e përcaktuara në paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të këtij neni obligohet ta sigurojë organizatori.

3. Kujdestarinë e zjarrfikësve, respektivisht shërbimin vëzhgues-alarmues në rastet e përcaktuara në paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të këtij neni e siguron pronari apo shfrytëzuesi, nëse nuk mund të vërtetohet pronari i objekteve të përmendura.

Neni 20

Kujdestaria zjarrfikëse në Komuna

Në komunat ku nuk është e organizuar kujdestaria zjarrfikëse, respektivisht shërbimi vëzhgues-

alarmues sipas nenit 19 të këtij ligji, nëse ekziston mundësia e shfaqjes së zjarrit të përmasave të mëdha, organet Komunale në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të detyruar të organizojnë kujdestarinë.

Neni 21

Proceset teknologjike në objekte të veçanta

1. Proceset teknologjike në të cilat shfrytëzohen apo prodhohen fluidet, gazrat e ndezshme apo materiet shpërthyes mund të kryhen vetëm në objekte, ose pjesë të tyre të ndara nga pjesët e tjera prodhuese dhe depozituese, të pajisura me pengesa rezistuese ndaj zjarrit që pamundësojnë përhapjen e zjarrit.

2. Proceset teknologjike nga paragrafi 1 i këtij neni, si dhe punët me flakë të hapur në afërsi të fluideve dhe gazrave të ndezshme, materieve shpërthyes dhe materieve të tjera të ngjashme që mund të shkaktojnë zjarr, duhet të organizohen në atë mënyrë që rreziku nga zjarri të mënjanohet, respektivisht të reduktohet, varësisht nga natyra dhe kushtet e punës.

3. Objektet sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të ndërtohen vetëm në vendet ku ndërtimi i tyre nuk cenon sigurinë nga zjarri të objekteve ekzistuese dhe mjedisit rrethues.

4. Normat teknike për mbrojtje nga zjarri në ndërtimin e impianteve për lëngjet e ndezshme, deponimin dhe toçitjen e tyre, përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria me propozim të Ministrit.

5. Ministri me akt nënligjor përcakton:

5.1. Normat teknike për furnizimin e mjeteve motorike me derivate të naftës, deponimin me toçitjen e derivateve të naftës në pikat e shitjes me pakicë;

5.2. Normat teknike për mbrojtjen e depove nga zjarri dhe shpërthimet.

KAPITULLI IV

LEJET DHE PAJISJA ME LEJE PËR AVANCIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 22

Lejet

1. AME-ja lëshon leje për personat juridikë për kryerjen e aktiviteteve si në vijim:

1.1. Projektimi i aparateve dhe instalimeve për detektim, lajmërim dhe fikje të zjarrit, si dhe testimi i rezistencës së tokëzimit në instalimet rrufepritëse;

1.2. Zhvillimi i analizave për organizimin e mbrojtjes nga zjarri dhe programeve për përmirësimin dhe avancimin e mbrojtjes nga zjarri;

1.3. Testimi i veçorive fizike-kimike, materieve të ndezshme të ngurta, të lëngëta dhe të gazta, si dhe përshtatshmërisë së përdorimit të të gjitha materieve në objektet e rrezikuara nga zjarri;

1.4. Zhvillimi i analizave për zonat e rrezikshme dhe përcaktimi i këtyre zonave në vendet të cilat janë të rrezikuara nga ndodhja e shpërthimeve të përzierjeve shpërthyes;

1.5. Zhvillimi i analizave të gjendjes ekzistuese të mbrojtjes nga zjarri;

1.6. Zhvillimi i trajnimeve fillestare në lëmin e mbrojtjes nga zjarri;

1.7. Zhvillimi i trajnimeve për përgatitjen e kandidatëve për dhënien e:

1.7.1. provimit profesional për aktivitete me materie të rrezikshme;

1.7.2. provimit profesional në fushën e mbrojtjes nga zjarri.

1.8. Hartimin e projektit kryesor të mbrojtjes nga zjarri.

2. Për zhvillimin e aktivitetit të projektimit të aparateve dhe instalimeve sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të këtij neni, personi juridik duhet të kenë kuadër profesional me përgatitje universitare, në fushën e mbrojtjes nga zjarri, të makinerisë, elektroteknike, teknologjike, të ndërtimtarisë dhe arkitekturës.

3. Për zhvillimin e analizave në organizimin e mbrojtjes nga zjarri dhe programeve për përmirësimin dhe avancimin e mbrojtjes nga zjarri, sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.2. të këtij neni, personi juridik përpos kriterit të përcaktuar në paragrafi 2 të këtij neni, duhet të ketë kuadër profesional me përgatitje universitare përkatëse.

4. Për zhvillimin e veprimtarisë në testimin e veçorive fizike-kimike, materieve të ndezshme të ngurta, të lëngëta dhe të gazta si dhe përshtatshmërisë së përdorimit të të gjitha materieve në objektet e rrezikuara nga zjarri sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të këtij neni personi juridik përpos kriterit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni duhet të ketë laborator për testime fiziko-kimike.

5. Për zhvillimin e veprimtarisë së analizave për zonat e rrezikshme dhe përcaktimi i këtyre zonave në vendet të cilat janë të rrezikuara nga ndodhja e shpërthimeve të përzierjeve shpërthyes, sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 të këtij neni, personi juridik përpos kriterit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni duhet të ketë edhe:

5.1. Pajisjet teknike;

5.2. Laboratorin për testimin e pajisjeve elektrike të tensionit të ulët dhe të lartë.

6. Për zhvillimin e veprimtarisë së zhvillimit të analizave të gjendjes ekzistuese të mbrojtjes nga zjarri sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të këtij neni, personi juridik përpos kriterit të përcaktuar sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të ketë edhe laboratorin për testimin e mbrojtjes kundër zjarrit dhe testime termometrike.

7. Për zhvillimin e trajnimeve për përgatitjen e kandidatëve sipas paragrafit 1, nën paragrafit 1.6. të këtij neni, personi juridik përpos kriterit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të ketë edhe hapësirën e përshtatshme të punës.

8. Për hartimin e elaboratit sipas paragrafit 1, nën paragrafit 1.7. të këtij neni, personi juridik duhet të ketë të punësuar persona me përgatitje të lartë profesionale të drejtimit teknik, mbrojtjes nga zjarri, makinerisë, elektroteknikës, teknologjisë, hidrologjisë, ndërtimtarisë dhe arkitekturës.

9. Për hartimin e projektit kryesor për mbrojtje nga zjarri sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të këtij neni, personi juridik duhet të ketë të punësuar kuadër profesional me përgatitje universitare, në fushën e mbrojtjes nga zjarri, të makinerisë, elektroteknike, teknologjike, të ndërtimtarisë dhe arkitekturës.

10. Për realizimin e aktivitetit të paraparë në nën-paragrafin 1.2 të këtij neni, personat juridikë mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me njëri-tjetrin.

11. Lejet mund të lëshohen për një ose më shumë veprimtari varësisht nga kërkesa e personit juridik dhe plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë ligj.

12. Lejet e përcaktuara në këtë nen lëshohen pa afat por personat juridik inspektohen rregullisht në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit përkatës të Inspektimeve.

13. Ministri me akt nënligjor përcakton:

13.1. Kushtet në aspektin e pajisjeve teknike dhe kuadrit profesional për pajisje me leje, sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 deri në 1.5 të këtij neni;

13.2. Zhvillimin i trajnimeve fillestare në lëmin e mbrojtjes nga zjarri sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.6 të këtij neni;

13.3. Përmbajtjen e projektit kryesor për mbrojtje nga zjarri sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të këtij neni.

14. Përmbajtja e programit dhe mënyra e dhënies së provimit profesional në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe punës me materie të rrezikshme sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria me propozim të Ministrit.

15. Procedura e lëshimit të lejeve sipas këtij neni bazohet në dispozitat e ligjit përkatës për leje dhe licenca dhe ligjin përkatës, procedurën e përgjithshme administrative.

Neni 23 **Kërkesa për Leje**

1. Për tu pajisur me leje për zhvillimin e aktiviteteve të caktuara në fushën e avancimit të mbrojtjes nga zjarri, personat juridikë paraqesin kërkesë në AME.

2. Kërkesa për të gjitha lejet bëhet në pajtim me ligjin përkatës për leje dhe licenca dhe ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

3. Shqyrtimin e kërkesave nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet nga komisioni i cili themelohet me vendim nga Drejtori i Përgjithshëm i AME-së. Në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, vendimin për themelimin e këtij komisioni e merr Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i AME-së.

4. Puna dhe procedura e komisionit sipas paragrafit 2 të këtij neni bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale në ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa përbërja dhe mandati rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 24 **Pagesa**

1. Pagesa për pajisje me leje, pëlqim dhe provim profesional përcaktohet në masën dhe vetëm për ato shërbime të cilat kanë kosto shtesë dhe asnjëherë nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare për ato shërbime.

2. Ministri me vendim cakton tarifën e pagesës lidhur me lejet, pëlqimet dhe provimin profesional sipas kërkesave të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 25 **Regjistri**

1. Ministria për secilin lejim të dhënë sipas këtij ligji, dërgon dhe përditëson në përputhje me legjislacionin në fuqi për regjistrin qendror të lejeve dhe licencave, së paku këto dhëna:

1.1. Llojin e lejimit;

1.2. Numrin dhe datën e lëshimit;

1.3. Njësinë dhe zyrtarin përgjegjës që ka dhënë lejin;

1.4. Të dhënat e personit juridik që është mbajtës i lejit, si dhe numrin e regjistrit të biznesit.

2. Për secilin lejim sipas këtij ligji lëshohet certifikatë. Certifikata përmban së paku elementet e përcaktuara në ligjin përkatës për sistemin e lejeve dhe licencave.

3. Zëvendësimi i certifikatës së lejit në rast të humbjes ose dëmtimit, ose në çdo rast tjetër kur kërkohet nga pala, bëhet në pajtim me ligjin përkatës për sistemin e lejeve dhe licencave.

Neni 26

Pezullimi dhe revokimi i lejeve

1. Pezullimi i lejeve të lëshuara sipas këtij ligji mund të bëhet në rastet kur:

1.1. Leja lëshohet në bazë të informatave të pasakta;

1.2. Identifikohen parregullsi dhe shkelje sipas kërkesës esenciale për mbrojtjen nga zjarri;

1.3. Në çdo rast tjetër, sipas këtij ligji dhe ligji përkatës për leje dhe licenca.

2. Revokimi i lejeve të lëshuara sipas këtij ligji mund të bëhet në rastet kur:

2.1. Nëse nuk plotësohen, ose nuk plotësohen më kushtet e përcaktuara në këtë ligj;

2.2. Në çdo rast tjetër, sipas këtij ligji dhe ligji përkatës për leje dhe licenca.

3. Pezullimi dhe revokimi i lejeve të lëshuara sipas këtij ligji, bëhet në pajtim me ligjin përkatës për leje dhe licenca.

Neni 27

Shqyrtimi i projektit kryesor për mbrojtje nga zjarri

1. Projekti kryesor për mbrojtje nga zjarri i objekteve dhe pjesëve të objekteve i nënshtrohet shqyrtimit teknik për mbrojtjen nga zjarri.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet nga komisioni i cili themelohet me vendim nga drejtori i Përgjithshëm i AME-së.

3. Puna dhe procedura e komisionit sipas paragrafit 2 të këtij neni bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative, ndërsa përbërja dhe mandati rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

KAPITULLI V

MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË MASAVE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Neni 28

Organet kompetente

1. Mbikëqyrjen dhe inspektimin për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri në objekte, pjesë të objekteve, pajisje, stabilimente në territorin e Republikës së Kosovës e kryejnë inspektorët për mbrojtje nga zjarri në kuadër të AME-së.

2. Inspektorët përkatës të AME-së, kur është e nevojshme mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri e kryejnë në bashkëpunim me inspektorët e tjerë të institucioneve përkatëse në pajtim me këtë ligj dhe ligjin përkatës për inspektimet.

3. Rregullat dhe procedurat për mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

4. Me vendimin e organit kompetent dhe me pëlqimin paraprak të Ministrisë, për aktivitete të caktuara të kontrollit të masave të parapara për mbrojtje nga zjarri mund të autorizohen njësitë zjarrfikëse dhe të shpëtimit, të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e këtij ligji.

5. Me vendimin nga paragrafi 4 të këtij neni, përcaktohen:

5.1. Lloji i objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit të cilat do të përfshihen në kontrollim;

5.2. Mënyra dhe procedura e kryerjes së punëve kontrolluese;

5.3. Mënyra e informimit të organit kompetent për emergjenca mbi mangësitë e konstatuara gjatë kontrollimit;

5.4. Kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë personat për ushtrimin e kontrollit nga aspekti i përgatitjes profesionale.

Neni 29

Inspektorë të mbrojtjes nga zjarri në AME

1. Inspektorët e mbrojtjes nga zjarri kanë statusin e nëpunësit civil dhe marrëdhënia e tyre e punës është e rregulluar sipas legjislacionit përkatës për zyrtarët publikë dhe ligjit përkatës për inspektimet.

2. Inspektorët për mbrojtje nga zjarri përveç kërkesave të përgjithshme të përcaktuar në legjislacionin përkatës, duhen të kenë kaluar provimin profesional.

Neni 30

Të drejtat dhe detyrat e inspektorit

1. Gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët kontrollojnë të gjitha objektet, pjesët e objekteve, stabilimentet, impiantet dhe ndërmarrin masa të tjera të nevojshme për vërtetimin dhe zbatimin e masave të përcaktuara për mbrojtje nga zjarri, sipas këtij ligji.

2. Gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët kanë të drejtë të hyjnë në objekte banimi, sipas kërkesës së banorëve, me qëllim të mënjanimit të rrezikut për jetën e njerëzve dhe pasurisë.

3. Pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e objekteve, duhet t'u mundësojnë inspektorëve mbikëqyrjen inspektuese, t'u ofrojnë dokumentacionin dhe të dhëna të nevojshme.

4. Inspektori është i detyruar që gjatë mbikëqyrjes inspektuese të dëshmojë identitetin dhe autorizimin e tij përmes kartelës identifikuese.

Neni 31

Mbajtja e procesverbalit nga inspektorët

1. Për kontrollin e kryer, inspektori për mbrojtje nga zjarri duhet të përpilojë procesverbal.

2. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet pronarit, respektivisht shfrytëzuesit të objektit apo pjesës së objektit.
3. Inspektorët për mbrojtje nga zjarri, janë të detyruar të mbrojnë informacionin e klasifikuar të pranuar gjatë inspektimit në pajtim me ligjin përkatës për informacionin e klasifikuar.
4. Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, Inspektori i mbrojtjes nga zjarri konstaton se nuk janë përmbushur kushtet nga neni 16 i këtij ligji, me vendim të arsyetuar e ndalon përdorimin atyre mjeteve dhe pajisjeve.
5. Pala e pakënaqur me vendimin sipas paragrafit 4 të këtij neni, ka të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave. Ankesa nuk ka efekt pezullues.

Neni 32

Njoftimi i organeve kompetente

Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët e mbrojtjes nga zjarri konstatojnë se gjatë ndërtimit të objekteve nuk janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zjarri, të parapara me projektin kryesor, ata informojnë organin kompetent për urbanizëm, i cili e ka dhënë lejen për ndërtim, për ndërmarrjen e masave ligjore.

Neni 33

Detyrimi i pronarëve dhe shfrytëzuesve të objekteve apo pjesëve të objekteve

1. Me qëllim të pengimit të shfaqjes së zjarrit, shpëtimit të njerëzve, pasurisë së rrezikuar nga zjarri pronarët, shfrytëzuesit e objekteve apo pjesëve të objekteve duhet të ndërmarrin masa të caktuara të mbrojtjes nga zjarri, të përcaktuara me këtë ligj, normat teknike, planet për mbrojtje nga zjarri dhe aktet tjera ligjore si më poshtë:

- 1.1. të mbajnë në gjendje të rregullt stabilimentet, instalimet apo pajisjet;
- 1.2. të rindërtojnë objektin apo pjesët e caktuara të objektit;
- 1.3. të largojnë nga objektet mbeturinat, të cilat kanë mbetur në procesin e punës apo janë të vendosura në vendet e ndaluara me ligjet përkatëse;
- 1.4. të largojnë nga objektet apo mjedisi lëndët, të cilat paraqesin rrezik për shkaktimin dhe përhapjen e zjarrit;
- 1.5. të mirëmbajnë të gjitha rrugët, përfshirë ato pyjore, në gjendje që të mundësojnë qasjen e automjeteve zjarrfikëse në çdo kohë;
- 1.6. të vendosin instalime statike, gjysmë statike, të lëvizshme, pajisje të tjera përkatëse dhe instalime për alarmim dhe fikje të zjarrit, si dhe pajisje dhe instalime të tjera mbrojtëse;
- 1.7. të sigurojnë dalje të nevojshme nga objektet apo pjesët e objekteve për mundësimin e evakuimit të papenguar të personave në rast zjarri;
- 1.8. të pamundësojnë afrimin e automjeteve, të cilat gjatë punës mund të hedhin shkëndija në vendet ku paraqitet rrezik nga zjarri;
- 1.9. të mbajnë në gjendje të rregullt pajisjen zjarrfikëse dhe mjetet e tjera për fikje të zjarrit, apo dhe ato pajisje dhe mjete t'i vënë në vend të caktuar dhe të dukshëm;
- 1.10. të largojnë gjësendet të cilat gjatë punës mund të shkaktojnë zjarr nga stabilimentet, instalimet dhe pajisjet;

1.11. të largojnë materiet e ndezshme, të cilat u janë shtuar elementeve konstruktive të objekteve, apo pjesëve të objekteve që u janë ri-konstruktuar hapësirat dalëse horizontale e vertikale të rrugëve, nëse ato elemente paraqesin rrezik për shkaktim dhe përhapje të zjarrit;

1.12. të pamundësojnë hedhjen nga jashtë të sendeve, të cilat do të mund të shkaktojnë zjarr në objekte në të cilat qasja është e kufizuar;

1.13. të sigurojnë sasinë dhe llojin e caktuar të pajisjeve teknike dhe mjeteve për alarmim dhe fikje të zjarrit;

1.14. të sigurojnë kujdestari zjarrfikëse në objekte dhe pjesët e objekteve në bazë të kategorizimit të objekteve dhe vlerësimit të rrezikshmërisë.

2. Për shkak të rrezikshmërisë së drejtpërdrejtë nga zjarri, inspektori për mbrojtje nga zjarri me vendim ndalon:

2.1. Magazinimin e lëndëve sekondare, repromaterialit/ lëndëve të para, produkteve finale dhe materieve të tjera;

2.2. Përdorimin e flakës së hapur në objektet e mbyllura dhe të hapura;

2.3. Përdorimin e objekteve, apo pjesëve të objekteve, stabilimenteve, instalimeve dhe pajisjeve të tjera nëse me adaptimin/përshtatjen e tyre, nuk mund të eliminohen mangësitë që mund të shkaktojnë zjarr;

2.4. Përdorimin e pajisjeve, instalimeve dhe mjeteve derisa nuk merren masat që rreziku të evitohet;

2.5. Kryerjen e punëve të caktuara në objekte apo pjesë të objekteve, siç janë ngjyrosja, rrjedhja e fluideve të ndezshme, gazrave, llaqeve dhe ndezja e ngjyrave, derisa nuk merren masat që rreziku të evitohet.

Neni 34 **Të dhënat dhe statistikat**

1. AME mban të dhëna dhe statistika në fushën e mbrojtjes nga zjarri për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

2. Lloji dhe mënyra e mbajtjes së të dhënave dhe statistikave nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 35 **E drejta e ankesës**

1. Për aq sa përcaktohet në këtë ligj, kundër secilit vendim për refuzim, pezullim dhe revokim të një autorizimi, pëlqimi, leje dhe licence apo një vendimi tjetër përfundimtar sipas këtij ligji, lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

2. Kundër vendimeve të lëshuara në procedurë të inspektimit sipas këtij ligji, lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

3. Organ epror që shqyrton ankesat sipas këtij neni është Komisioni i Ankesave i themeluar me vendim të Ministrit.

4. Përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe procedura e vendimarrjes së komisionit përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

KAPITULLI VI TRAJNIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

Neni 36 Trajnimi dhe aftësimi

1. Trajnimi dhe aftësimi profesional i mbrojtjes nga zjarri kryhet nga agjencia përkatëse e Ministrisë për trajnime të specializuara në këtë fushë, si dhe institucionet tjera arsimore të cilat janë të licencuara dhe akredituara nga Ministria përkatëse për arsim, shkencë, teknologji dhe inovacion.
2. Kushtet teknike të cilat duhet të plotësojë institucioni, i cili bën trajnimin dhe aftësimin profesional të zjarrfikjes dhe shpëtimit, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 37 Financimi

1. Mjetet për financimin e aktiviteteve dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes nga zjarri, sipas këtij ligji sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Mjetet për zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri, të përcaktuara me planin e mbrojtjes nga zjarri të Komunave, sigurohen nga buxhetet Komunale përkatëse

KAPITULLI VII DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 38 Gjobat

1. Me gjobë prej pesëqind (500) deri në tremijë (3,000) Euro, dënohet personi juridik, i cili:
 - 1.1. Nuk posedon Leje për projektin kryesor, i cili po ashtu nuk është në harmoni me kushtet e rregullimit hapësinor sipas nenit 12 të këtij ligji;
 - 1.2. Kryen aktivitetet në kundërshtim me dispozitat e neneve 13, 15 dhe 16 të këtij ligji;
 - 1.3. Kryen aktivitetet për kontrollimin dhe servisimin e aparateve të mbrojtjes nga zjarri në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 16 të këtij ligji;
 - 1.4. Trajnimin dhe aftësimin profesional të zjarrfikësve e kryen në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 36 të këtij ligji.
2. Me gjobë prej treqind (300) deri pesëqind (500) Euro dënohet personi përgjegjës i personit juridik për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijë (1,000) Euro dënohet për kundërvajtje personi juridik, i cili:
 - 3.1. Nuk miraton dhe sjell Rregulloren me të cilën përcaktohen masat dhe punët lidhur me rregullimin dhe përparimin e mbrojtjes nga zjarri, apo nuk zbaton masat në avancimin e mbrojtjes nga zjarri të parapara me Rregulloren për Mbrojtjen nga Zjarri, sipas paragrafit 2 të nenit 9 të këtij ligji;
 - 3.2. Kryen punimet për përpunimin e sipërfaqeve të daljeve horizontale dhe vertikale dhe rrugëve dalëse në objekte dhe përdor material ndërtimor i cili nuk i justifikon karakteristikat rezistuese ndaj zjarrit sipas paragrafit 4 të nenit 14 të këtij ligji;

3.3. Nuk mirëmban në gjendje të rregullt stabilimentet, pajisjet elektrike, të gazit, ventilimin dhe instalime të tjera, oxhaqet dhe pajisje të tjera dhe nëse për mirëmbajtje nuk posedon dokumentacion sipas paragrafit 2 të nenit 15 të këtij ligji;

3.4. Nuk kontrollon instalimet së paku një herë në vit nga personi juridik i autorizuar, ose për kontrollet e bëra nuk mbahet evidencë sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 16 të këtij ligji;

3.5. I vë në qarkullim pajisjet, stabilimentet që përdoren për fikje, lajmërim dhe pengim të përhapjes së zjarrit, për të cilat nuk është siguruar certifikata e personit juridik të autorizuar për gjendjen e tyre të rregullt sipas paragrafit 2 të nenit 15 të këtij ligji;

3.6. Vendos në qarkullim pa leje stabilimentet, pajisjet dhe mjetet, të cilat nevojiten për fikje të zjarrit dhe lajmërim, për të cilat nevojitet Leja sipas neni 17 të këtij ligji;

3.7. Nuk posedon stabilimentet, pajisjet dhe mjetet për fikje të zjarrit sipas neni 18 të këtij ligji;

3.8. Nuk siguron kujdestarinë zjarrfikëse në formën e shërbimit për lajmërim me anë të vrojtimit, me mjetet dhe pajisjet përkatëse për shuarje të zjarrit sipas neni 19 të këtij ligji;

3.9. Nuk i mundëson inspektorit për mbrojtje nga zjarri kryerjen e punës së tij, apo refuzon të japë në shikim dokumentacionin me shkrim, apo të ndihmojë në të dhënat e tjera të nevojshme informuese sipas paragrafit 3 të nenit 30 të këtij ligji;

3.10. Nuk zbaton masat sipas paragrafi 1 të nenit 33 të këtij ligji.

4. Për kundërvajtje nga paragrafi 3 i këtij neni dënohet me gjobë prej njëqind (100) deri treqind (300) Euro edhe personi përgjegjës i personit juridik.

5. Me gjobë prej njëqind (100) deri treqind (300) Euro dënohet për kundërvajtje personi juridik, i cili:

5.1. Si pronar, apo shfrytëzues i objekteve, pjesëve të objekteve apo mjedisit, nuk mban në gjendje të rregullt pajisjet, stabilimentet elektrike, gazrat, ventilimet dhe instalimet tjera, oxhaqet dhe pajisje të tjera, të cilat mund të shkaktojnë zjarr dhe nëse për mirëmbajtje nuk posedon dokumentacion sipas paragrafit 1 të nenit 15 të këtij ligji;

5.2. Nuk u mundëson inspektorëve për mbrojtje nga zjarri kryerjen e punëve të tyre dhe dhënien e shënimeve të domosdoshme sipas paragrafit 3 të nenit 30 të këtij ligji;

5.3. Nuk zbaton Vendimet e inspektorit të Agjencisë, sipas paragrafit 4 neni 31 të këtij ligji;

5.4. Nuk zbaton Vendimin sipas paragrafit 2 të nenit 33 të këtij ligji.

Neni 39 **Masa të tjera**

1. Inspektorët në mënyrë të pavarur zhvillojnë procedurën e inspektimit, nxjerrin vendime dhe shqiptojnë masa ndëshkimore sipas neni 38 të këtij ligji.

2. Sanksioni kundërvajtës i shqiptuar me gjobë sipas këtij ligji mund të paguhet menjëherë. Në rastin e pagimit të gjobës menjëherë i dënuari lirohet nga pagimi i 50% të vlerës së shumës së gjobës së shqiptuar.

3. Për kundërvajtjen nga paragrafi 3 dhe 4 i neni 38 të këtij ligji, nëse përsëritet kundërvajtja,

përveç gjobës në të holla shqiptohet edhe masa e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë në afat prej gjashtë (6) muajsh.

4. Për kundërvajtjen nga paragrafi 5 i nenit 38 të këtij ligji, nëse përsëritet kundërvajtja edhe pas masës sipas paragrafit 2 të këtij neni, përveç gjobës në të holla shqiptohet edhe masa për pezullim të aktivitetit.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40 Aktet nënligjore

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj nxirren më së largu një (1) vit pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 41 Dispozitat Kalimtare

1. Personat juridikë duhet të harmonizojnë rregulloret për mbrojtje nga zjarri të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji në afatin kohor prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi.

2. Personat sipas nenit 15, nenit 16 dhe nenit 18 të këtij ligji duhet që në afat prej gjashtë (6) muajsh, nga dita e nxjerrjes së akteve nënligjore përkatëse, të harmonizojnë veprimtarinë e tyre me dispozitat e këtyre akteve.

3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për objektet, pjesët e objekteve dhe mjedisin me interes të veçantë në rast se nuk janë të rregulluara me Ligj të veçantë në fushën e mbrojtjes nga zjarri.

4. Të gjitha Lejet e lëshuara deri ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të mbesin të vlefshme, brenda afatit për të cilin janë lëshuar.

5. Personat juridikë që janë të autorizuar për ushtrimin e veprimtarisë për mbrojtje nga zjarri, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, brenda afatit një (1) vjeçar duhet të harmonizojnë dokumentin e lejimit me dispozitat e këtij ligji.

6. Shqyrtimi i kërkesave të reja për dhënie të lejeve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji bëhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 42 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga Zjarri.

Neni 43 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-261
11 korrik 2024**

Shpallur me dekretin Nr. DL-104/2024, datë 31.07.2024 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu